



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2024:138654

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05695097

P.nr.103/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.Q nga Drenasi, rruga "...", Komuna e Drenasit, për vepër penale Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1998/2024, datë.08.05.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, për dhënjën e urdhërit ndëshkimor, vërejtje gjyqësore, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë, PP.II.nr.1998/2024, datë.08.05.2024, me datë **16.05.2023**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET KËRKESA E PROKURORIS THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM në Prishtinë PP.II.nr.1998/2024, datë.08.05.2024, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I AKUZUARI: D.Q, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur me datën.... në Drenas, Komuna e Drenasit, ku edhe tani e ka vendbanimin rruga "...", me numër personal ..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion ndërrmarrës, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: më datën 08.04.2023, rreth orës 16:58, në Drenas, për shkak të një mosmarrëveshje paraprake rreth një tenderi në Kompaninë "New Co Feronikel", i akuzuari D.Q, me qëllim të frikësimit, i kishte shkruar SMS të dëmtuarit F.H, me anë të cilit kishte kanosur të njëjtin seriozisht, me fjalët "o hajn, hiq mos e qel, se kam me të llamit, valla ska zot që të pshton prej meje, veq ban dallavere ti", me të cilin rast tek i dëmtuari F.H, kishte shkaktuar ndenjën e ankthit, frikës dhe të pasigurisë për jetën,-

-me këtë ka kryer vepër penale Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,38,69,81,82 dhe nenit 181 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe nenit 495,359,360,364,449 par.3. dhe 462 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Ku të akuzuarit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të i shqiptoi sanksion më të rëndë penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari F.H nga Fushë Kosova, rruga e “....” nr...., lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Deparatamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1998/2024, datë.08.05.2024, ka akuzuar të akuzuarin, për veprë penale Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), poashtu ka ushtruar kërkesën për dhënjën e urdhërit ndëshkimor, vërejtje gjyqësore, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor PP.II.nr.1998/2024, datë.08.05.2024, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga e pandehura.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënjën e urdhërit ndëshkimorë, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë për dhënjën e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, vërejtje gjyqësore, në vështirim të nenit 495 par.1. të KPP-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimin penal me nr. të rastit 2024-AG-0184, dt.16.04.2024, të SP në Drenas, raportin fillestar të incidentit, me nr. të rastit 2024-AG-0184, dt.08.04.2024, të SP në Drenas, procesverbalin e marrjës në pyetje për të dëmtuarin-dëshmitarin F.H, dt.08.04.2024, të SP në Drenas dhe procesverbalin e marrjës në pyetje për të dyshuarin-të akuzuarin D.Q, dt.08.04.2024, të SP në Drenas, konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën veprë penale është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj, dhe të njëjtit i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse duke patur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit duke u bazuar në nenin 81 të KPRK-së. Dhe në bazë të nenit 82 par.1. lidhur me par.2. të KPRK-së, të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të i shqiptoi sanksion më të rëndë penal, me bindjen se shqiptimi i vërejtjes gjyqësore është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të pandehurit, dhe se i njëjti do të ndikoi që të parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë

personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që i akuzuari të paguajë në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 30 €, gjykata e bazoi nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së. duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të akzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet euro (20 €).

Vendimin që i dëmtuari F.H nga Fushë Kosova, rruga e “...” nr..., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, të udhëzohet në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 462 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht të kësaj kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.103/2024, datë:16.05.2024

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të ushtrojë kundërshtim në afat prej 8 ditë, nga dita e pranimit dhe kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate. Nëse kundërshtimi nuk hudhet për shkaqe të arsyeshme, atëherë gjykata do të caktoj mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë sipas aktakuzes së ushtruar. Nëse nuk paraqitet kundërshtimi apo paraqitet pas afatit, urdhëri ndëshkimorë merrë formën e prerë dhe ekzekutohet.